

FJALA E GUVERNATORIT

Ekonomia shqiptare ka pasur një trend pozitiv zhvillimi deri në muajt e parë të vitit 2026.

Sipas të dhënave të INSTAT-it, vëllimi i aktivitetit ekonomik u rrit me 3.7% gjatë tremujorit të tretë të vitit 2025, ndërkohë që informacioni indirekt i disponuar sugjeron një ritëm të përafërt rritjeje edhe në tremujorin e katërt. Rritja ekonomike e vitit 2025 ka pasqyruar zgjerimin e konsumit, të investimeve dhe të eksportit të shërbimeve, ndërsa eksporti i mallrave ka vijuar të shënojë rënie dhe politika fiskale ka vijuar të ruajë një natyrë konsoliduese. Rritja e kërkesës për mallra e shërbime është shoqëruar me rritje të shpejtë të punësimit dhe të pagave në sektorin privat jobujqësor, duke mundësuar rritje të të ardhurave të familjeve shqiptare.

Paralelisht me këto zhvillime, treguesit kryesorë të shëndetit ekonomik, monetar dhe financiar të vendit kanë ardhur në përmirësim.

Inflacioni i çmimeve të konsumit shënoi një nivel mesatar prej 2.2% në tremujorin e katërt dhe 2.4% në dy muajt e parë të vitit 2026. Nivelet e ulëta të inflacionit gjatë tremujorëve të fundit kanë pasqyruar nivelet e ulëta të inflacionit të importuar, si pasojë e forcimit të kursit të këmbimit dhe e rënies së çmimeve të mallrave bazë në tregjet ndërkombëtare, ecurinë e kontrolluar të inflacionit të brendshëm, efektin kalimtar të goditjeve pozitive të ofertës, si dhe pritjet e ankoruara për inflacionin.

Gjithashtu, borxhi publik dhe borxhi i huaj i vendit kanë ardhur në reduktim, treguesit e shëndetit të sektorit bankar mbeten në nivele të larta, bilancet financiare të bizneseve shqiptare janë likuide dhe treguesi i cilësisë së portofolit të kredisë vijon të shënojë përmirësim.

Politika monetare e kujdesshme e Bankës së Shqipërisë ka pasur një kontribut të rëndësishëm pozitiv në këtë tablo zhvillimesh. Reagimi në kohë dhe i vendosur i saj në mbrojtje të stabilitetit të çmimeve ka bërë të mundur kontrollin e pritjeve për inflacionin dhe ruajtjen e stabilitetit monetar e financiar të vendit. Gjithashtu, lehtësimi proaktiv i qëndrimit të politikës monetare gjatë vitit 2025, i realizuar nëpërmjet uljes së normës bazë të interesit dhe rritjes së prezencës në tregjet valutore, ka ndihmuar në uljen e kostove të financimit në ekonomi dhe reduktimin e shpejtësisë së forcimit të kursit të këmbimit.

Kjo politikë është pasqyruar në një rritje të shpejtë të kreditimit gjatë vitit 2025, duke mbështetur zgjerimin e konsumit dhe të investimeve në ekonomi me fonde me kosto të ulët.



Perspektiva e zhvillimeve ekonomike në të ardhmen mbetet pozitive. Ekonomia shqiptare pritet të shënojë një rritje ekonomike solide dhe të përafërt me potencialin, ndërsa inflacioni pritet të kthehet gradualisht drejt objektivit gjatë vitit 2026. Megjithatë, rreziqet ndaj këtyre parashikimeve janë rritur ndjeshëm gjatë javëve të fundit, si pasojë e konfliktit ushtarak në Lindjen e Mesme dhe ndikimit të tij në rritjen e çmimit të naftës dhe të energjisë në tregjet botërore. Në ngjashmëri me goditjen që pasoi konfliktin në Ukrainë, ajo pritet të ketë ndikim rritës në inflacion dhe rënës në rritjen ekonomike. Megjithatë, intensiteti i këtij ndikimi në ekonominë shqiptare do të varet nga kohëzgjatja e goditjes dhe reagimi i tregjeve botërore, faktorë këta që për momentin rrethohen nga pasiguri të larta.

Në këto rrethana, ne vendosëm të mos ndryshojmë qëndrimin e politikës monetare në mbledhjen e parë të vitit 2026. Megjithatë, ne do të monitorojmë me kujdes zhvillimet e ardhshme dhe nuk do të hezitohet të marrim masat e duhura për respektimin e objektivit tonë të inflacionit prej 3%. Ruajtja e një inflacioni të ulët dhe të qëndrueshëm ka qenë dhe do të mbetet një element thelbësor dhe i panegociueshëm i zhvillimit të shëndetshëm ekonomik të vendit dhe i rritjes së mirëqenies së shoqërisë.

